



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi Kritike e Shfrytëzuar Aktivisht në React Native Community CLI

Data: 10/02/2026

Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	2
Referenca	2

Përmbledhje Ekzekutive

Është identifikuar një **dobësi kritike e ekzekutimit të kodit nga distanca (RCE)**, e gjurmuar si **CVE-2025-11953**, në paketën **@react-native-community/cli-server-api**, një komponent kyç i **React Native Community CLI**.

Kjo dobësi lejon **sulmues të paaumentikuar nga distanca** të ekzekutojnë **komanda arbitrare të sistemit operativ** në kompjuterët e zhvilluesve që ekzekutojnë **React Native Metro development server**. Dobësia është veçanërisht serioze sepse serveri i zhvillimit mund të jetë i ekspozuar ndaj rrjeteve të jashtme, duke mundësuar shfrytëzim **pa nevojë për akses lokal**. Problemi prek versione specifike të **React Native CLI** (kryesisht **v18 dhe v19**) si dhe versionet përkatëse të **React Native (v0.80 dhe v0.81)**. Është raportuar **shfrytëzim aktiv në terren**.

Informacione Teknike

Detaje të Dobësisë

- **CVE ID:** CVE-2025-11953
- **Rrezikshmëria:** Kritike
- **CVSS v3.1 Score:** 9.8
- **Vektori:** CVSS:3.1/AV:N/AC:L/PR:N/UI:N/S:U/C:H/I:H/A:H
- **Lloji i dobësisë:** Ekzekutim Kodi nga Distanca (RCE)
- **Komponenti i prekur:** @react-native-community/cli-server-api
- **Statusi:** Shfrytëzohet aktivisht

Versionet e Prekura

Direkt të cenueshme:

- **@react-native-community/cli-server-api:**
 - Versionet **4.8.0** → **20.0.0-alpha.2**

Versione praktike të prekura të CLI / React Native:

- **React Native v0.80** → **CLI v18**
- **React Native v0.81** → **CLI v19**

Versionet e Rregulluara

- **CLI v20.0.2+** (për versionet e mbështetura të React Native)

Për versionet më të vjetra të React Native:

- RN v0.81 → përditësoni CLI në v19.1.2
- RN v0.80 → përditësoni CLI në v18.0.1

Rekomandime

AKSK rekomandon subjektet që përdorin React Native duhet ta trajtojnë këtë çështje si urgjente dhe të aplikojnë menjëherë patch-et e publikuara nga prodhuesi..

Referenca

<https://jfrog.com/blog/cve-2025-11953-critical-react-native-community-cli-vulnerability/>